

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7183
E martë, 14 maj 2024
Çmimi 0.50 €

Në 43-vjetorin e rënies
përkujtohen Tahir dhe
Nebih Meha FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ASK-ja THOTË SE KA KËRKESË PËR SHTYRJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË POPULLSISË

FAQE 4-5



Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në konferencën mbajtur të hënën ka njoftuar se komuna e Dragashit ka kërkuar që procesi i regjistrimit të

popullsisë, që përfundon më 17 maj, të shtyhet. Drejtori i ASK-së, Avni Kastrati, ka thënë se po diskuton me këtë komunë për ta mbështetur

stafin dhe procesin që të shtyhet. Sipas të dhënave të fundit, deri më tani në Kosovë janë regjistruar mbi 1 milion e 420 mijë banorë

SCHOLZI I KËRKON SERBISË TA ZBATOJË MARRËVESHJEN E OHRIT F.3



MBI 170 POLICË U HETUAN GJATË 2023-S, U NGRITËN KALLËZIME PENALE NDAJ 74 PJESËTARËVE F.3



AKTUALE



KRYEMINISTRI SUEDEZ, I HAPUR PËR PRANIMIN E ARMËVE BËRTHAMORE F.2

PRESIDENCA MAQEDONASE E JUSTIFIKON PËRDORIMIN E EMRIT 'MAQEDONI' F.5

MINISTRI BRITANIK VJEN NË KOSOVË, ME SVEÇLËN FLET PËR SIGURINË KUFITARE F.3

EKONOMI



BE-ja KONFIRMON SE MË 15 MAJ DO TË DISKUTOHET PËR DINARIN SERB F.8

PANXHA, LETËR PUBLIKE ZËVENDËSMINISTRES GASHI, E AKUZON PËR VJEDHJE TË KONCEPTIT 'MADE IN KOSOVA' F.8

SPORT



TETËVJETORI I ANËTARËSIMIT NË FIFA, ADEMI: TË VENDOSUR TË SIGUROJMË TË ARDHME TË NDRITSHME F.12

RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kollegji
BIZNESI**
www.kollegjibiznesi.com
info@kollegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kryeministri suedez, i hapur për pranimin e armëve bërthamore

STOKHOLM, 13 MAJ - Kryeministri i Suedisë, Ulf Kristersson, tha se është i hapur që ta lejojë dislokimin e armëve bërthamore në tokën suedeze në kohë lufte, teksa kritikët i kanë bërë thirrje anëtares së re të NATO-s që të ndalojë një dislokim të tillë. Parlamenti i Suedisë pritet që në qershor të votojë për Marrëveshjen për bashkëpunim të mbrojtjes me Shtetet e Bashkuara, që do t'i mundësojë Uashingtonit qasje në bazat ushtarake në Suedi dhe do ta lejojë ruajtjen e pajisjeve ushtarake dhe armëve në shtetin skandinav. Suedia iu bashkua aleancës ushtarake perëndimore të NATO-s në mars të këtij viti. Në javët e fundit janë rritur thirrjet nga Shoqata suedeze për Paqe dhe Arbitrazhit dhe të tjerë, që Qeveria të përfshijë në

Marrëveshjen për bashkëpunim të mbrojtjes me ShBA-në se Suedia nuk do të lejojë armë bërthamore në tokën e saj. Qeveria suedeze vazhdimisht ka insistuar se nuk ka nevojë që ta ketë të shkruar këtë ndalesë, duke u thirrur "në konsensusin e gjerë" në Suedi sa iu përket armëve bërthamore, por edhe në vendimet e Parlamentit që ndalon armët bërthamore në Suedi edhe në kohë paqeje. Por, Kristersson tha të hënën se kur bëhet fjalë për kohë lufte, është diçka tjetër. "Lufta është një çështje krejt tjetër, do të varej krejtësisht nga çfarë do të ndodhte", tha ai për radion publike suedeze. "Në skenarin më të keq, shtetet demokratike në pjesën tonë të botës duhet të jenë në gjendje ta mbrojnë veten kundër shteteve që na kërcënojnë me



armë bërthamore". Ai insistoi se çdo vendim për dislokimin e armëve bërthamore në Suedi do të

merret nga Suedia, e jo ShBA-ja. "Suedia vendos për territorin suedez", tha ai. Por, ai theksoi se "i gjithë

qëllimi i anëtarësimit tonë në NATO dhe i mbrojtjes sonë është të sigurohemi që të mos kemi një situatë të tillë". Nëse Ukraina do të ishte anëtare e NATO-s, "nuk do të sulmohej nga Rusia", tha ai. Partia Social Demokrate e Suedisë, që ishte në pushtet kur Suedia aplikoi për anëtarësim në NATO në maj të vitit 2022, atëbotë deklaroi se do të punonte për t'i shprehur "rezervat tona kundër dislokimit të armëve bërthamore dhe bazave të përhershme në territorin suedez". Shtetet fqinje nordike, Danimarka dhe Norvegjia, që janë anëtare të NATO-s, kanë refuzuar t'i lejojnë shtetet e huaja të kenë baza të përhershme ushtarake në territoret e tyre apo të dislokojnë armë bërthamore në kohë paqeje.

Blinken kritikon planet e luftës të Izraelit

WASHINGTON, 13 MAJ - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka dhënë disa prej deklaratave më të ashpra publike deri më tani për Izraelin lidhur me luftën e tij në Gazë. Kryediplomati amerikan tha se taktikat izraelite kanë prodhuar "një humbje të tmerrshme të jetës së civilëve të pafajshëm", por nuk kanë arritur t'i neutralizojnë liderët dhe luftëtarët e Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - gjë që mund të çojë në një kryengritje të qëndrueshme. Në dy intervista televizive, Blinkeni theksoi se ShBA-ja beson se forcat izraelite "duhet të largohen nga Gaza", po ashtu tha se pret që të shohë plane të besueshme nga Izraeli për sigurinë dhe qeverisjen në këtë territor pasi të përfundojë lufta. Hamas është rishfaqur në disa pjesë të Gazës, tha Blinken, dhe "një veprim i ashpër" nga forcat izraelite në qytetin jugor, Rafah,



do të rrezikonte që ta lërë aleatin më të afërt të Uashingtonit në Lindjen e Mesme që të përballet "me një kryengritje të qëndrueshme". Ai tha se ShBA-ja ka punuar me shtetet arabe dhe të tjerët për javë

të tëra për të zhvilluar "plane të besueshme për sigurinë, për qeverisjen, për rindërtimin" në Gazë, por "ne nuk kemi parë që kjo të bëhet nga Izraeli... Ne duhet ta shohim këtë gjë". Blinkeni, po ashtu, tha se

përderisa Izraeli po hyn më thellë në Gazë, një operacion ushtarak atje "në fillim mund të ketë sukses", por rrezikon të shkaktojë "dëm të tmerrshëm" te popullata duke mos zgjidhur problemi "që ne duam të zgjidhim, që është që Hamasi të mos mund të qeverisë sërish Gazën". Më shumë se një milion palestinezë janë strehuar në Gazë për shkak të luftimeve në pjesë të tjera të territorit. Izraeli ka thënë se në këtë qytet gjenden edhe katër batalione të Hamasit. Mënyra se si Izraeli po e zhvillon luftën, tha Blinken, ka bërë që shteti të jetë "në një trajektore, potencialisht duke trashëguar një kryengritje me shumë luftëtarë të Hamasit të armatosur, apo që vakuumi të mbushet me kaos, me anarki dhe që me gjasë ky vakum do të mbushet nga Hamasit". Blinkeni, po ashtu, për herë të parë përsëriti gjetjet e një raporti të paraqitur javën e kaluar në Kongres që thoshte se armët që ia ka ofruar ShBA-ja Izraelit, të cilat

janë përdorur në Gazë, potencialisht kanë shkelur ligjin ndërkombëtar humanitar. "Kur bëhet fjalë për përdorimin e armëve, shqetësimet për incidente, marrë parasysh dëmin që u është shkaktuar fëmijëve, grave, burrave, është e arsyeshme të vlerësohet se në disa raste Izraeli ka vepruar në mënyra që nuk janë në përputhje me ligjin ndërkombëtar humanitar", tha ai. Blinkeni, po ashtu, të dielën ka biseduar me ministrin e Mbrojtjes të Izraelit, Yoav Gallant, të cilit ia ka përsëritur kundërshtimin e ShBA-së për ofensivën në Rafah, tha Departamenti amerikan i Shtetit. Lufta në Gazë nisi më 7 tetor, pasi Hamas sulmoi jugun e Izraelit duke vrarë afër 1 200 persona, shumica civilë, dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë. Ofensiva e Izraelit ka vrarë më shumë se 35 000 palestinezë, shumica gra dhe fëmijë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë.

Separatistët humbin shumicën në Katalonjë

BARCELONË, 13 MAJ - Socialistët e kryeministrit spanjoll Pedro Sanchez shënuan fitore në zgjedhjet rajonale katalonase të mbajtura të dielën, më 12 maj, në të cilat Carles Puigdemont dhe separatistët e tjerë humbën shumicën pas dhjetë vjetësh në pushtet. Votimet e së dielës u mbajtën gjashtë vjet pasi Puigdemont udhëhoqi përpjekjen e

dështuar për pavarësi, që nxiti një prej krizave më të këqija politike në Spanjë në dekada. Të udhëhequr nga Salvador Illa, që ka qenë ministër i Shëndetësisë në Spanjë gjatë pandemisë së koronavirusit, partia e Socialistëve Katalanas fitoi 42 nga 135 ulëset e Parlamentit rajonal, apo nëntë ulëse më shumë sesa në zgjedhjet paraprake të

mbajtura më 2021. Duke e cilësuar rezultatin si historik, Sanchez shkroi në "X" se këto rezultate zgjedhore do të shënojnë nisjen "e një epoke të re në Katalonjë". "Një epokë e re për të gjithë katalanët, pavarësisht se çfarë mendojnë ata", tha Illa para mbështetësve të tij gjatë një fjalimi pas fitores.



Scholz i kërkon Serbisë ta zbatojë Marrëveshjen e Ohrit

PRISHTINË, 13 MAJ - Kancelari i Gjermanisë, Olaf Scholz, i ka kërkuar Serbisë ta zbatojë Marrëveshjen në rrugën drejt normalizimit të raporteve me Kosovën, që njihet edhe si Marrëveshja e Ohrit.

Gjatë një telefonate të zhvilluar me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, sipas njoftimit të Berlinit, Scholz ka theksuar rëndësinë e dialogut për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. "Gjermania ka riafirmuar mbështetjen e tij për këtë proces. Ai [Scholz] ka qartësuar obligimet e Serbisë për zbatimin Marrëveshjes së Ohrit", u tha në njoftim.

Këtë marrëveshje, së bashku me Aneksin për zbatimin e saj, Kosova dhe Serbia e kanë arritur vitin e kaluar. Marrëveshja nuk është nënshkruar, por ndërmjetësi ka thënë se ajo është ligjërish e obligueshme për palët.

Blloku evropian ka thënë se palët nuk kanë nisur zbatimin e saj.

Marrëveshja prej 11 nenesh parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i

zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

Ndërkaq, Vuçiqi përmes një postimi në "Instagram" tha se me Scholzin ka biseduar për situatën e serbëve që jetojnë në Kosovë dhe për çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Udhëheqësi serb tha se e ka informuar kancelarin gjerman "në detaje për gjendjen pothuajse të padurueshme për komunitetin serb në Kosovë", por edhe për "shmangien e vazhdueshme të Prishtinës nga përbushja e detyrimeve të saj të pranuar dhe nënshkruara, veçmas në lidhje me formimin e Asociacionit".

Në kuadër të dialogut për normalizimin e raporteve, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, Kosova dhe Serbia kanë arritur dy marrëveshje për themelimin e Asociacionit, më 2013 dhe 2015.

Por, më 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës gjeti se Marrëveshja mbi parimet për themelimin e Asociacionit nuk ishte në harmoni të plotë me aktin më të lartë juridik të shtetit, duke thënë se duhet të harmonizohet përmes akteve nënligjore.

Megjithatë, qeveri të njëpasnjëshme të Kosovës



refuzuan ta zbatojnë marrëveshjen, duke shprehur frikë se asociacioni i tillë njëzetnik mund të ndikojë në funksionalitetin e duhur të shtetit.

Gjermania, së bashku me shtetet e tjera në BE, por edhe Shtetet e Bashkuara, vazhdimisht i bëjnë thirrje Kosovës ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, po ashtu ka thënë se ekzekutivi që ai udhëheq refuzon të pranojë që Asociacioni të jetë kusht për pranimin e vendit në organizatën e Këshillit të

Evropës.

"Qeveria nuk e pranon kushtëzimin e anëtarësimit në KiE me Asociacion. Për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, ne bisedojmë në Bruksel, e jo në Strasburg", tha Kurti më 8 maj.

Vuçiqi, gjatë bisedës me Scholzin, po ashtu, i ka kërkuar Gjermanisë mbështetje në rrugën e integritit evropian. "E ritheksa se Serbia vazhdimisht avokon për shtimin e aktiviteteve diplomatike në kontekstin e të gjitha konflikteve aktuale dhe çështjeve të hapura që rëndojnë Evropën dhe

rajonin e Ballkanit Perëndimor, gjë që e ka demonstruar gjithmonë në të gjitha forumet dhe iniciativat", shkroi Vuçiqi në llogarinë e tij në "Instagram".

Në procesin e zgjerimit të BE-së aktualisht ndodhen dhjetë shtete, përfshirë gjashtë shtete nga Ballkani Perëndimor. Prej shteteve që janë në këtë proces, nëntë kanë statusin e vendit kandidat, ndërsa vetëm Kosova nuk e ka atë status. Kosova kishte aplikuar për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2022, por kërkesa e saj nuk është shqyrtuar nga Bashkimi Evropian.

Haradinaj - Stublla: Refuzimi i takimit me Kurtin nga LDK-ja dhe AAK-ja tregon mungesë të gatishmërisë për ta qeverisur vendin



Prishtinë, 13 maj - Partitë opozitare, LDK-ja dhe AAK-ja, refuzuan ftesën e kryeministrit Albin Kurti për t'u takuar dhe për të diskutuar rreth përbushjes së agjendës legislative për sesionin pranveror.

Krerët e të dyja partive, Lumir Abdixhiku dhe Ramush Haradinaj, e panë të vonuar këtë ftesë nga ana e kryeministrit Kurti.

I vetmi që iu përgjigj pozitiv kësaj ftese ishte kreu i PDK-së,

Memli Krasniqi.

Ish-ministrja e Punëve të Jashtme, Meliza Haradinaj-Stublla, ka thënë se partitë që kanë refuzuar këtë takim nuk janë të gatshme ta qeverisin vendin.

Ajo në "Facebook" ka shkruar se sa do që të jetë e vonshme kjo ftesë, refuzimi i saj tregon se liderët nuk janë të sinqertë për interesin shtetëror të vendit. "Liderët dhe partitë politike që refuzojnë ndërtimin (edhe pse të

vonshëm) të unitetit nuk janë gati të qeverisin vendin dhe nuk janë të sinqertë për interesin shtetëror të Kosovës", ka shkruar Haradinaj-Stublla.

Pas refuzimit që mori nga dy partitë opozitare, kryeministri Albin Kurti u shpreh se është i interesuar të takohet me të gjithë.

Kurti ka thënë se ka qenë i hapur gjithmonë dhe do të vazhdojë të jetë edhe në vitin e fundit të qeverisjes.

Ministri britanik vjen në Kosovë, me Sveçlën flet për sigurinë kufitare

Prishtinë, 13 maj - Ministri britanik kundër migrimit të paligjshëm, Michael Tomlinson, po qëndron për vizitë në Kosovë. Ai është takuar me ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka njoftuar ambasada britanike përmes një postimi në faqen zyrtare. "Sot në Kosovë ne mirëpritëm

ministrin britanik kundër migrimit të paligjshëm, Michael Tomlinson. Ai shkëmbeu pikëpamjet me ministrin Xhelal Sveçla mbi mënyrat se si vendet tona mund ta intensifikojnë bashkëpunimin në sigurinë e kufirit", thuhet në njoftimin e ambasadës.

Ambasada shton se të dy

ministrat shkuan për të parë një demonstrim në pikën kufitare në Vermicë. "Pastaj të dy ministrat u nisën për të parë një demonstrim të mbështetjes praktike britanike në kufirin në Vermicë, në rrugë për në një konferencë rajonale në Tiranë për migracionin ilegal dhe sigurinë e kufirit", thuhet në njoftim.





ASK-ja thotë se ka kërkesë për shtyrjen e procesit të regjistrimit të popullsisë

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në konferencën mbajtur të hënën ka njoftuar se komuna e Dragashit ka kërkuar që procesi i regjistrimit të popullsisë, që përfundon më 17 maj, të shtyhet. Drejtori i ASK-së, Avni Kastrati, ka thënë se po diskuton me këtë komunë për ta mbështetur stafin dhe procesin që të shtyhet. Sipas të dhënave të fundit, deri më tani në Kosovë janë regjistruar mbi 1 milion e 420 mijë banorë

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 MAJ - Komuna e Dragashit javën e kaluar ka bërë kërkesë që procesi i regjistrimit të popullsisë, që përfundon më 17 maj, të shtyhet. Kështu kanë bërë me dije përfaqësues të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, duke shtuar se kërkesa të ngjashme pritet të bëhen më 13 maj nga komuna të tjera.

Gjatë konferencës javore ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të këtij institucioni, Avni Kastrati, ka thënë se ASK-ja po diskuton me këtë komunë, në mënyrë që ta mbështesë me staf dhe që procesi të mos shtyhet. "Dragashi ka sfidë me komunitete. Ka disa zona që kanë refuzuar të regjistrohen dhe besoj

që edhe në Dragash do të kryhet me kohë", është shprehur Kastrati.

Sipas të dhënave të fundit, deri më tani në Kosovë janë regjistruar mbi 1 milion e 420 mijë banorë. "Në aspektin statistikor nuk paraqet ndonjë sfidë shtyrja për disa ditë. Ne do t'i shqyrtojmë ato kërkesa dhe do të shikojmë nëse ka ndonjë bazë, arsye të mirë që të shtyhet", tha Kastrati.

Ai shtoi se procesi po shkon mirë dhe pritet janë që regjistrimi të përfundojë gjatë kësaj jave në të gjitha komunat e Kosovës.

Kastrati ka bërë me dije se Prishtina dhe Prizreni nga sot do të hapin edhe zyra në komuna ku qytetarët mund të shkojnë të regjistrohen.

Në këtë proces, përmes një platforme online, po regjistrohen

edhe qytetarët e Kosovës që jetojnë jashtë vendit. Kastrati nga ASK-ja tha se deri më tani janë regjistruar mbi 400 000 pjesëtarë të diasporës.

Ndërkaq, sa iu përket pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, ASK tha se të gjitha po marrin pjesë në regjistrim, por në komunat në veri, të banuara me shumicë serbe, ende ka hezitim.

Më 5 prill, kur edhe filloi regjistrimi, Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë e cila gëzon mbështetjen e Beogradit, kishte thënë se serbët nuk do të merrnin pjesë në procesin e regjistrimit të popullsisë.

Regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë në vitin 2011 nuk ishte mbajtur në katër komunat në veri: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan - të banuara me shumicë serbe, ndërsa serbët nga komunat e tjera në jug, me ftesë të Beogradit, kryesisht e kishin bojkotuar procesin.

Sipas Ligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, çdo person mund të gjobitet nga 30 deri në 2 000 euro nëse refuzon t'i japë informacionet e kërkuara nga

regjistruesi.

Gjobat janë edhe më të mëdha, deri në 20 000 euro, për biznese. Për herë të parë, në kuadër të regjistrimit, është përfshirë edhe një formular për regjistrimin e dëmeve që u janë shkaktuar ekonomive familjare gjatë luftës. Për herë të parë, në kuadër të regjistrimit, është përfshirë edhe një formular për regjistrimin e dëmeve që u janë shkaktuar ekonomive familjare gjatë luftës. Autoritetet në të kaluarën kanë thënë se vlera e dëmeve ekonomike që Serbia ia ka shkaktuar Kosovës në luftën e viteve 1998-'99 është rreth 22 miliardë euro, mirëpo të dhëna publike nuk ekzistojnë.

Përveç autoriteteve shtetërore, një pjesë të të dhënave do të mund t'i përdorin edhe hulumtuesit, mediet, academia, e organizatat joqeveritare dhe ato ndërkombëtare, për përpilim të raporteve të ndryshme.

ASK-ja ka paralajmëruar që rezultatet preliminare të regjistrimit do t'i publikojë brenda tre muajve.

Të gjitha informacionet që japin qytetarët janë të fshehta dhe është shumë e rëndësishme që informacionet të jepen të sakta.

Osmani u bënë thirrje qytetarëve të regjistrohen

Vetëm edhe katër ditë kanë mbetur për t'u regjistruar. Me këtë rast, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, u ka bërë thirrje qytetarëve në Kosovë dhe mërgatë të regjistrohen. "Kanë mbetur vetëm edhe 4 ditë për t'u regjistruar! Një lutje për të gjithë qytetarët tanë në Kosovë e në mërgatë: Regjistrohuni! Investimet në infrastrukturë, shëndetësi, arsim e shumë fusha të tjera të rëndësishme, do të përcaktohen nga të dhënat që mblidhen nga procesi i regjistrimit. Regjistrohuni që të dëgjohet zëri juaj, të identifikohen nevojat e secilit dhe që çdo qytetar të përfaqësohet, pa dallim", ka thënë Osmani.

Presidenca maqedonase e justifikon përdorimin e emrit 'Maqedoni'



SHKUP, 13 MAJ - "Presidentja maqedonase në daljet e saj publike ka të drejtë ta përdorë emrin 'Maqedoni' si akt i së drejtës personale për vetëvendosje dhe vetidentifikim, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në përputhje me vlerat dhe parimet evropiane". Kështu thuhet në komunikatën e lëshuar nga Zyra e presidentes së Maqedonisë së Veriut, Gordana Silanovska-Davkova, pas reagimeve të kryeministrit grek Kyriakos Mitsotakis, por edhe të Bashkimit Evropian. Ndër të tjera, në komunikatë thuhet se "presidentja Gordana Silanovska-Davkova do t'i përmbahet përdorimit zyrtar të emrit kushtetues". Aty sqarohet se betimin solemn Davkova e ka nënshkruar bazuar në Kushtetutën e vendit, respektivisht me emrin kushtetues. "Institucionet maqedonase në pesë vitet e fundit i kanë përmbushur pothuajse plotësisht obligimet e tyre nga Marrëveshja e Prespës dhe presidentja pret që të gjithë partnerët e Maqedonisë së

Veriut t'i respektojnë obligimet bilaterale dhe shumëpalëshe që i kanë marrë ndaj vendit", thuhet në komunikatën e lëshuar nga Zyra e presidentes, Gordana Silanovska-Davkova. Presidentja e re e Maqedonisë së Veriut, Gordana Silanovska-Davkova, të dielën, më 12 maj, gjatë betimit nuk e përmendi emrin Maqedoni e Veriut, por vetëm Maqedoni. "Betohem se do ta mbroj sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë e Republikës së Maqedonisë", kishte deklaruar Davkova duke lexuar betimin para deputetëve të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut. Lidhur me këtë, kryeministri i Greqisë, Kyriakos Mitsotakis, ka deklaruar se Athina nuk do të tolerojë "lapsuse" të tjera të krerëve shtetërorë të Maqedonisë së Veriut në raport me detyrimet që kanë për zbatimin e Marrëveshjes së Prespës. Mitsotakis ka thënë se "Greqia refuzon manipulime si ato, me të cilat zonja Silanovska hapi mandatin e saj" dhe i bëri thirrje t'i

respektojë detyrimet ligjore dhe t'u përmbahet obligimeve që dalin nga roli i saj si presidente. "Ne deklarojmë se kategorikisht nuk do të pranojmë 'lapsuse' të ngjashme. Dhe, përsërisim, se çdo përparim në marrëdhëniet dypalëshe, si dhe çdo hap i Shkupit drejt Evropës, varet nga respektimi i sigurtë i marrëveshjeve, nga përdorimi i drejtë i emrit kushtetues të shtetit fqinj. Dhe, sigurisht, nga shmangia e sfidave", transmetojnë mediet greke një deklaratë të kryeministrit grek Mitsotakis. Ndërkaq, njohësit e çështjeve kushtetuese thanë se Gordana Siljanovska Davkova gjatë dhënies së betimit presidente e Maqedonisë së Veriut, duke përdorur emrin e vjetër të shtetit, ka bërë shkelje të Kushtetutës. Sipas tyre, ajo duhet ta respektojë Kushtetutën dhe kjo nënkupton se ajo emrin e shtetit duhet ta përdorë si në të folur ashtu edhe në të shkruar. Në vitin 2018 Shkupi dhe Athina kanë nënshkruar atë që njihet si Marrëveshja e Prespës për ndryshimin e emrit nga Maqedoni në

Maqedonia e Veriut. Kjo marrëveshje i ka dhënë fund kontestit shumëvjeçar duke ua hapur rrugën përpjekjeve të vendit për integrim në BE dhe NATO. Marrëveshja nga pala maqedonase ishte nënshkruar nga ish-kryeministri Zoran Zaev dhe qeveria që drejtohej nga ai. Qeveria që pasoi, e drejtuar nga ish-kryeministri Dimitar Kovačevski (po ashtu nga Lidhja Social Demokrate sikurse Zaev), ka respektuar në tërësi detyrimet e kësaj marrëveshjeje, duke përdorur emrin Maqedonia e Veriut. Marrëveshja me Greqinë në vazhdimësi është kundërshtuar nga VMRO DPMNE-ja, e cila në zgjedhjet e 24 prillit dhe 8 majit fitoi bindshëm zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare, ndërsa drejtuesit e saj në disa raste kanë përsëritur se në komunikimin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar do ta përdorin emrin e vjetër të shtetit. Bazuar në Marrëveshjen e Prespës, Maqedonia e Veriut detyrohet që emrin e ri të shtetit ta zbatojë si në

përdorim të brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Athina zyrtare së fundi kishte refuzuar një kërkesë të Shkupit për shtyrjen e afatit për ndërrimin e dokumenteve personale edhe pas 12 shkurtit 2024 për shkak të pamundësisë për ndërrimin e tyre brenda kohës së paraparë. Pala greke në disa raste ia ka rikujtuar Shkupit se moszbatimi i të gjitha obligimeve që dalin nga kjo marrëveshje mund të ketë pasoja në procesin e integritetit të saj në BE. Lidhur me zhvillimet që nxitin betimi i presidentes së re, ka reaguar edhe Bashkimi Evropian (BE), duke shprehur keqardhje që Gordana Silanovska-Davkova nuk e përdori emrin kushtetues të shtetit. "BE-ja rithekson rëndësinë e respektimit të plotë të marrëveshjeve ekzistuese dhe ligjrisht të detyrueshme, përfshirë Marrëveshjen e Prespës me Greqinë", tha zëdhënësja e BE-së për çështje të sigurisë dhe politikës së jashtme, Nabila Massrali, në një komunikatë të dielën.

Plani 'semafori': Policia e Prishtinës i konfiskon 34 patentëshoferë

Prishtinë, 13 maj - Njësitë Rajonal i Trafikut rrugor i policisë në Prishtinë është duke vazhduar zbatimin e planeve operative për kontrollin e shtuar në

trafik. Në kuadër të këtyre angazhimeve ka nisur implementimi i planit "Semafori". "Deri tani u janë konfiskuar 34

patentëshoferë ngasësve që nuk kanë respektuar sinjalizimin e semaforëve. Angazhimet për sigurinë në trafik do të kenë shtrirje në të gjitha rrugët e rajonit

të Prishtinës dhe do të vazhdojnë derisa të vlerësohet që është arritur efekti i dëshiruar", është thënë në njoftimin e policisë.





Në 43-vjetorin e rënies, përkujtohen Tahir dhe Nebih Meha

SKENDERAJ, 13 MAJ - Në 43-vjetorin e rënies së Tahir dhe Nebih Mehës, është nderuar sakrificat e dëshmorëve në luftën e tyre përballë forcave të mëdha jugosllave, më 13 maj të vitit 1981. Me këtë rast, janë vendosur buqeta me lule te varri i Tahir dhe Nebih Mehës në Prekaz të Skenderajt, nga kryetari i komunës Fadil Nura, nënkryetari Sami Lushtaku, kryesuesja e Kuvendit,

Adelina Spahiu, gjeneralë dhe ish-komandantë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, familjarë, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, drejtorë komunalë, anëtarë të Kuvendit dhe qytetarë të shumtë. Po në këtë përvjetor është bërë edhe zbulimi i pllakës së shtëpisë së Nebih Mehës, e cila kishte shërbyer si bazë e UÇK-së në kohën e luftës.



Po vazhdojnë punimet në ndërtimin e shtegut të ri në Kalanë e Prizrenit

PRIZREN, 13 MAJ - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se janë duke vazhduar punimet në ndërtimin e shtegut të ri, me gurë, që shpie për në Kalanë e Prizrenit, dizajni i të cilit është ideuar në harmoni me atmosferën e ambientit përreth, që është një përpjekje për ta ruajtur trashëgiminë kulturore dhe historike të këtij

lokaliteti të rëndësishëm turistik të qytetit. "Përveçse do të sjellë një përvojë të veçantë për vizitorët vendës dhe të huaj, një shteg i bukur dhe i përshtatshëm do të nxisë edhe zhvillimin e aktiviteteve turistike dhe kulturore në gjithë zonën e kalasë dhe të nënkalasë", ka njoftuar komuna e Prizrenit.

Diskutohet për projekt-statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj



FERIZAJ, 13 MAJ - Në sallën e Kuvendit të Komunës së Ferizajt është mbajtur konsultim publik për projekt-statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj. Në hapjen e këtij konsultimi ka marrë pjesë drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dr. Kemajl

Emini, Ddr. Nadire Imeri, drejtoreshë e QKMF-së si dhe zëvendës drejtori Afrim Abazi. Në hapjen e këtij konsultimi publik, drejtori dr. Kemajl Emini ka thënë se ky konsultim publik po mbahet për herë të dytë për statutin e QKMF-së. E dr. Nadire Imeri ka thënë se shumica e komunave në

Kosovë veç se kanë aprovuar një statut të tillë dhe po funksionojnë.

Të pranishmit në këtë konsultim publik kanë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me këtë statut. Ky dokument do të jetë në konsultim me publikun deri më 4 qershor.



Hamza pret në takim ambasadorin e Austrisë, diskutojnë për zhvillimet në vend

MITROVICË, 13 MAJ - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur në takim ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Georg Schnetzer. Hamza falënderoi ambasadorin Schnetzer për përkrahjen e shtetit të Austrisë ndaj shtetit të Kosovës, e cila është e dëshmuar ndër vite në etapat më

të rëndësishme të shtetformimit dhe shtetndërtimit. Ai shtoi se me ambasadorin Schnetzer diskutuan për vazhdim të bashkëpunimit në rrugën e vetme që duhet të ketë Kosova, për anëtarësim në organizatat kryesore ndërkombëtare, në krah me aleatët e dëshmuar të vendit.



Fillon mbjellja e luleve në hapësirat gjelbëruese në qytetin e Mitrovicës

MITROVICË, 13 MAJ - Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë në Mitrovicë ka filluar mbjelljen e luleve në hapësirat gjelbëruese, përfshirë këtu mirëmbajtjen e tyre, në mënyrë që qyteti i Mitrovicës të duket i bukur. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Granit Tmava, është

shprehur i lumtur që me punën e javës së kaluar, qyteti i Mitrovicës ka arritur dukshëm të marrë pamje të bukur. "Ne bashkë po ndërtojmë një qytet më të bukur, më të gjelbër dhe po ndërtojmë një ambient i cili do t'i shërbejë shoqërisë sonë", është shprehur drejtoria Tmava.

Kosova kërkon ndihmë nga Rama për anëtarësim në Këshill të Evropës

PRISHTINË, 13 MAJ - Jeton Zulfaj, këshilltar i kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në një intervistë për rrjetin evropian të lajmeve "Euronews" në gjuhën shqipe, deklaroi se anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës është interes edhe i Shqipërisë dhe, së këndejmi, kërkoj nga ekzekutivi shqiptar të punojë në mënyrë aktive për heqjen e kushtëzimit franko-gjerman për Kosovën. "Ne presim nga Shqipëria që ajo të luajë rol aktiv në këtë çështje, sepse kështu edhe duhet të jetë në çështjet që kanë të bëjnë me afirmimin e shtetësisë së Kosovës. Ne nuk presim që të kërkojmë nga Shqipëria të punojë për interesat tona, por këtë ta bëjnë në mënyrë aktive dhe proaktive", ka theksuar këshilltari politik i kreut të ekzekutivit të Kosovës të hënën.

Zulfaj shtoi se në kontekstin e procesit të anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, marrëdhëniet e tensionuara midis shefit të Qeverisë së Kosovës dhe kryeministrit shqiptar, Edi Rama, nuk duhet të ndikojnë në mosangazhimin e Shqipërisë në këtë proces, derisa nënvizoi se Shqipëria mund ta përdorë ndikimin ndaj disa shteteve skeptike rreth anëtarësimit. "Asnjë ngërç nuk

mund të pengojë në këtë drejtim kur është në pyetje sovraniteti i Kosovës. Dhe sidomos në këtë pikë kyçe, ku anëtarësimi i Kosovës është jashtëzakonisht domethënës për çka do të duhej të kishte angazhim maksimal dhe përpjekje të shumta që të hiqen pengesat nga disa vende ku Shqipëria mund të ketë rol dhe ndikim", ka potencuar Zulfaj.

Kur kanë mbetur më pak se një javë nga mbledhja e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, zyra për media në kuadër të këtij institucioni konfirmoi të hënën se organi vendimmarrës nuk do të diskutojë për Kosovën në mbledhjen që pritet ta mbahet gjatë kësaj jave në Strasburg të Francës. "Kosova nuk është në agjendën e mbledhjes së Komitetit të Ministrave javën e ardhshme. Nuk kemi më shumë informacion në këtë fazë", thuhet në një përgjigje të shkurtër të Këshillit të Evropës për mediet në Prishtinë.

Në bazë të agjendës, ministrat e Punëve të Jashtme të 46 vendeve anëtare të Këshillit të Evropës do ta mbajnë sesionin pranveror më 17 maj 2024 që përkon me 75-vjetorin e themelimit të organizatës kryesore të kontinentit evropian për të drejtat e njeriut, por



Kosova nuk është në agjendë.

Kosova u mbështet nga shumica e deputetëve në Asambleenë e Parlamentare të Këshillit të Evropës për ta kaluar fazën e parafundit drejt anëtarësimit në panteonin e kombeve të barabarta evropiane, por nuk janë përfaqësuesit e popullit ata që e japin fjalën e fundit, por

ministrat e jashtëm.

Megjithatë, anëtarësimi i Kosovës për momentin nuk është as në agjendë. Kjo ka të ngjarë të çojë në shtyrjen e vendimmarrjes finale për vendin e vogël ballkanik, ndoshta për të paktën një vit, nëse jo më shumë, përveç nëse bëhet progres drejt Asociacionit të Komunave me Shumicë

Serbe.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, hodhi poshtë kushtin e Gjermanisë dhe Francës që nëse Kosova dëshiron të bëhet anëtarja më e re e organizatës më të vjetër, ajo duhet të ndër marrë hapa konkretë dhe të paktheshëm drejt ngritjes së një mekanizmi vetëmenaxhues për serbët e Kosovës.

Mbi 170 policë u hetuan gjatë 2023-s, u ngritën kallëzime penale ndaj 74 pjesëtarëve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 MAJ - Kryeshefi ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës, Kushtrim Hodaj, ka deklaruar se gjatë vitit 2023 kanë rekomanduar suspendimin e 71 punonjësve policorë të gradave dhe niveleve të ndryshme, kurse ndaj 74 pjesëtarëve u ngritën kallëzime penale.

Hodaj, gjatë raportimit në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, ka theksuar se gjatë vitit të kaluar kanë hetuar mbi 170 të dyshuar. "Kemi hetuar 178 të dyshuar, prej tyre 156 punonjës policorë



dhe 22 qytetarë që kanë qenë në raste të përbashkëta me zyrtarët policorë. Kemi ngritur

74 kallëzime penale ndaj të dyshuarve, kemi arrestuar 35 punonjës dhe qytetarë. Kemi

rekomanduar suspendimin e 71 punonjësve policorë të gradave dhe niveleve të ndryshme", ka thënë Hodaj.

Ai vitin 2023 e ka vlerësuar "të suksesshëm" në përmbushjen e mandateve të tyre. "Lufta kundër korrupsionit vazhdon të jetë një ndër prioritetet tona. Kemi arritur ta rrisim besueshmërinë te qytetarët. Jemi angazhuar ta rrisim besimin qytetar në sistemin e trajtimit të ankesave. Kemi pranuar 1 697 ankesa gjatë vitit 2023 nga qytetarët. 32 për qind të këtyre ankesave i kemi orientuar për hetim penal. Jemi angazhuar për parandalimin dhe luftimin e krimit dhe

keqmenaxhimit", ka thënë ai. Më 30 mars Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) kishte suspenduar Blerim Kuqin dhe Flurim Pirkun, dy pjesëtarë të Policisë së Kosovës, pasi dyshohej se kishin tejkualuar autorizimet policore gjatë përdorimit të forcës. Të dy këta zyrtarë policorë të suspenduar kanë qenë pjesëtarë të ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Në njoftimin e IPK-së theksohej se vendimi për suspendimin e ish-pjesëtarëve të UÇK-së ka ardhur pas një informacioni që policia e ka marrë në Suharekë, pasi që dy policët kishin intervenuar në një incident në këtë qytet.

Ushtarët e FSK-së përfundojnë ushtrimin fushor "Ujku Alfa"

PRISHTINË, 13 MAJ - Regjimenti i Tretë i Komandës së Forcave Tokësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës ka përfunduar me sukses ushtrimin fushor Nivel Togu "Ujku Alfa", ku objektivi e ushtrimit ishte përgatitja e personelit ushtarak të

kompanisë A në nivel togu me municion luftarak duke përdorur metodologjinë e trajnimit, zvarritje (dry), ecje (blank) dhe vrapim (live).

Për ta përcjellë nga afër trajnimin ishte komandanti i Forcave Tokësore,

gjeneralbrigade Hysen Dreshaj, komandanti i Regjimentit të Tretë, nënkolonel Ilir Beqiri, përfaqësues ushtarakë nga Ambasada Amerikane të cilët u ndanë të kënaqur me rrjedhën dhe përgatitjen profesionale të ushtrimit.



BE-ja konfirmon se më 15 maj do të diskutohet për dinarin serb



PRISHTINË, 13 MAJ - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, ka konfirmuar se më 15 maj Kosova dhe Serbia do ta zhvillojnë takimin e radhës për çështjen e ndalimit të përdorimit të dinarit serb në Kosovë. Ky do të jetë takimi i shtatë me radhë në nivel të kryenegociatorëve kushtuar kësaj teme, teksa në gjashtë takimet e mëherëshme kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, dhe ai i Serbisë, Petar Petković, nuk kanë arritur pajtim për ndonjë zgjidhje kompromisi.

Gjatë konferencës për medie në Bruksel, duke folur për takimin e radhës për çështjen e dinarit, Stano tha se BE-ja pret që palët të dëshmojnë gatishmëri për gjetjen e një zgjidhjeje të përkohshme praktike, e cila, sipas tij, do t'i ndihmonte qytetarët e prekur nga vendimi i Bankës Qendrore të Kosovës. "Presim që palët të kenë

sjellje evropiane dhe të gjejnë një zgjidhje kompromisi. Kryenegociatorët mëtojnë të gjejnë zgjidhje përmes diskutimeve konfidenciale, e këto janë mënyra evropiane për gjetjen e zgjidhjeve. BE-ja vazhdon t'u ndihmojë atyre që ta gjejnë kompromisin i cili është i nevojshëm sepse kjo ndikon në jetën e njerëzve", tha Stano.

Më herët, Stano kishte deklaruar se takimi i 15 majit do të jetë takimi i fundit për temën e dinarit. I pyetur për pritjet që takimi i së mërkurës të jetë vërtet i fundit, Stano tha se "BE-ja gjithmonë pret që secili takim ku kërkohet zgjidhje për problemet të jetë edhe final, por kjo varet nga gatishmëria e palëve për të gjetur zgjidhje".

Zëdhënësi i BE-së ka thënë se hezitimi për të gjetur zgjidhje për çështjen e dinarit është duke ndikuar edhe në çështje të tjera me

të cilat nuk po merren në dialog për shkak se fokusi tash është në këtë çështje. Ai tha se prioritet mbetet zbatimi i Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve që Kosova dhe Serbia arritën vitin e kaluar.

Njoftimi për takimin e radhës të dialogut, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, vjen pasi gjatë fundjavës që shkoi përfundoi periudha tranzitore e Rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës, që parasheh euron si valutën e vetme për kryerjen e pagesave në Kosovë. Kjo rregullore hyri në fuqi më 1 shkurt, por autoritetet vendosën një fazë tranzitore, që mundëson lehtësim për zbatimin e këtij vendimi.

Rregullorja e BQK-së parasheh ndëshkime për ata që përdorin dinar serb. Por, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, deklaroi për transmetuesin publik të Kosovës,

se rregullorja e BQK-së ka për qëllim ligjshmërinë "dhe jo ndëshkimin dhe dënimin".

Pavarësisht se ka kaluar afati i periudhës tranzitore, në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe, sipas reporterëve të Radios Evropa e Lirë, dinari serb po vazhdon të qarkullojë.

Ndryshe, në raundin e fundit të dialogut, të mbajtur më 25 prill, kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, tha se i dërguari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak, ka paraqitur një propozim të ri që synon t'i përafrojë qëndrimet e palëve sa i përket ndihmës financiare nga Serbia për serbët në Kosovë.

Bislimi nuk tregoi detaje konkrete të propozimit, por tha se Kosova dhe Serbia duhet t'i japin mendimet e tyre për të në shtatë ditët e ardhshme. "Le të themi që propozimi i sotëm është më i

detajuar se ai i kaluari dhe sqaron më mirë disa prej pikave dhe vërejtjeve që ne kemi pasur në idetë e tij fillestare", deklaroi Bislimi më 25 prill, duke shtuar se propozimi është një përpjekje e mirë për të gjetur zgjidhje dhe se brenga kyçe e Lajçakut është të adresojë se si personat e prekur nga vendimi i BQK-së të mund të vazhdojnë të marrin ndihmë financiare nga Serbia.

Vendimi i BQK-së ka zemëruar Serbinë, e cila përmes buxhetit të saj shtetëror u dërgon ndihmë financiare serbëve që jetojnë në Kosovë.

Bashkësia ndërkombëtare i ka kërkuar Kosovës ta pezullojë rregulloren në mënyrë që t'u jepet kohë qytetarëve të përshtaten me praktikën e re. Por, Qeveria e Kosovës ka ngulur këmbë se fjala është për një vendim të pavarur të BQK-së e jo për vendim politik.

Panxha, letër publike zëvendësministres Gashi, e akuzon për vjedhje të konceptit 'Made in Kosova'



PRISHTINË, 13 MAJ - Drejtori i Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Astrit Panxha, përmes një letre të hapur të publikuar në "Facebook", e ka denoncuar zëvendësministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi, për vjedhje të idesë "Made in Kosova". "E nderuar znj. Liza Gashi, përmes kësaj letre po të drejtohem personalisht që të sqaroj dhe prezantoj para opinionit publik tendencën tënde për të përvetësuar konceptin Made in Kosova si dhe për të konfiskuar markën tregtare 'Made in

Kosova'. Miqësisht po të them se qasjen dhe mënyrën që e ke zgjedhur është totalisht e gabuar", ka shkruar Panxha. Ai thotë se kjo ide ishte e tij dhe e disa personave të tjerë që nga 2015-ta. Ai ka paralajmëruar se këtë çështje mund ta bëjë edhe lëndë gjyqësore. "Unë fuqishëm besoj në vullnetin e mirë dhe dëshirën për t'i përmirësuar gabimet. Te gjithë gabojmë Liza! Unë besoj që ti do të reflektosh pozitivisht mbi këtë çështje para se fillojmë me proceset gjyqësore. Prandaj në mungesë të ideve origjinale Liza, po ta

shtri prapë dorën e bashkëpunimit siç ta kam bërë në muajin prill të vitit 2023 për 'Made in Kosova. Prandaj unë Astrit Panxha si autor dhe ideator i konceptit dhe fushatës 'Made in Kosova' do t'i drejtohem presidentes së vendit, kryeministrit, kryetarit të Kuvendit dhe te gjitha instancave relevante që të njoftohen për këtë tentim të përvetësimit dhe konfiskimit të pronës. Po ashtu nuk do të lë gur pa e lëvizur deri sa të triumfoje drejtësia morale dhe ligjore mbi këtë çështje", ka shkruar ai.

Jeta problematike e aktorit Mickey Rooney dhe rënia e tij e trishtueshme



Djaloshi i artë i Holivudit: Mickey ROONEY

Nga: David ALEXANDER /
The Daily Telegraph
Përkthimi: *Telegrafi.com*

Holivud, 1942. Mickey Rooney ishte ylli më i madh në botë. I kishte kaluar tri vjet rresht si aktori më i suksesshëm në aspektin komercial. Kishte fituar një çmim special Oscar për yjet fëmijë dhe ishte nominuar edhe për një Oscar për aktorin më të mirë të rritur. Laurence Olivier e quajti “aktori më i madh nga të gjithë”. Dhe, ishte gati të martohej me Ava Gardnerin.

Milton Kejns, 2009. Gjashtëdhjetë e shtatë vjet më vonë dhe pas tetë martesave, Mickey Rooney i vobektë bënte pantomimë me Bobby Davronin dhe finalistin e Big Brother VIP-së, Ben Adams. E kaluara e tij e trazuar përfshinte varësinë nga ilaçet, falimentimet e shumta dhe vrasjen tragjike të gruas së tij të pestë nga ish-dashnori i saj. Zgjedhjet e tij në karrierë ishin gjithnjë e më të çuditshme dhe ai abuzohej nga i biri i cili u akuzua se nuk i kishte dhënë ushqim dhe ilaçe Rooneyt, ndërkohë që përdorte paratë e yllit të moshuar për ta financuar jetën e vet luksoze.

Nuk ka yje moderne si Mickey Rooney, i cili vdiq 10 vjet më parë.



Mickey Rooney në moshën pesëvjeçare

Më i madh se jeta, me vetëm 157 centimetra gjatësi, Rooney mund të aktronte, të këndonte, të kërcente, të luante në piano (dhe kompozoi një simfoni të respektueshme), të të bindte si në komedi ashtu edhe me Shekspirin, dhe të flinte me shumicën e grave më të famshme të Holivudit – pavarësisht se dukej, siç e përshkroi veten, “gjysmë njeri, gjysmë xhuxh”. Dhe, i bëri që të gjitha këto në jetën e vet personale që ishte më e çuditshme sesa letërsia më e çuditshme.

Pas fillimit kaq spektakolar, asnjë aktor tjetër nuk e ka përjetuar rënien kaq të gjatë – si në jetën private ashtu edhe në publik. Rooney lindi si Joseph Yule, Jr., në vitin 1920, nga prindërit artistë të burleskës në Bruklin. Përvoja e tij e parë në biznesin e spektaklit ndodhi gjatë 15 muajve të parë të jetës, kur u paraqit në shfaqjen e prindërve të vet i veshur me një kostum në miniaturë dhe duke pirë puro prej gome.

Prindërit e Rooneyt u ndanë dhe ai udhëtoi në Holivud me nënën e vet. Në moshën gjashtëvjeçare bëri debutimin në ekranin e madh dhe merr rolin e karakterit Miki Mekguajër [Mickey McGuire] – rol të cilin e luajti për 60 vjet në 80 filma dhe që ia dha

emrin Mickey Rooney.

Në vitin 1935, 15-vjeçari Rooney dha performancën më të mirë të karrierës, kur u shqua si Paku i Ëndrës së një nate vere, me rolin që e ndërtoi duke iu përkushtuar habive të botës tjetër – duke e zbuluar dialogun shekspirian me tinguj të çuditshëm dhe duke e fuqizuar fantazmagorinë e filmit me stilin e vet të energjisë së furishme.

Roli përcaktues i Rooneyt si adoleshenti i guximshëm Endi Herdi [Andy Hardy] dukej relativisht i frenuar dhe i parashikueshëm. Por, e luajti në 16 filma shumë të njohur të viteve 1937-1958.

Filmat e Endi Herdit e bënë Rooneyt yllin më të madh në botë, një status të cilin e kishte kur 19-vjeçarja Ava Gardner mbërriti në MGM në vitin 1941. Gardner ka thënë se “praktikisht ishte ende fëmijë” kur e takoi për herë të parë burrin e saj të ardhshëm. “Ende nuk e dija se ai ishte ujku më i madh në tufë. Ishte tërheqës për zonjat. Dhe, këtë ai e dinte”.

Gratë që ranë pas sharmit të Rooneyt, gjatë kulmit të famës së tij, përfshinin listën e gjatë të talenteve të MGM-të, nga e famshmja Norma Shearer që ishte 20 vjet më e vjetër se Rooney gjatë lidhjes së tyre, tek e

reja Lana Turner e cila Rooney u quajti "Endi erektiv"! Gardneri shpejt u pëlqye edhe nga Rooney dhe dyshja u martuan. Megjithatë, marrëdhënia e tyre ishte një luftë e përhershme për pushtet, e prirë për shpërthime të mëdha emocionale. Rooney gjithmonë e mohoi tradhtinë, por Gardner pretendoi se burri i saj ishte gjithmonë kurorëshkelës. Për hakmarrje, pasi flinin bashkë, ajo e tallte trupin e tij të vogël. Kur Rooney i dehur para Garderit e lexoi listën me emrat e grave me të cilat kishte fjetur – duke dhënë komente shoqëruese mbi pikat e forta dhe të dobëta të tyre në dhomën e gjumit – durimi i saj me të mbaroi dhe ajo e merr vendimin e guximshëm për t'u ndarë nga djaloshi i artë i Amerikës.

MGM u përpoq të heshte historitë e sjelljes së keqe të Rooneyt. Audiencia nuk e dinte se mungesa e seriozitetit të Endi Herdit në jetën reale shtrihej te shthurjet dhe te varësia nga droga.

Vesi i drogës së Rooneyt në fakt u iniciua nga studiot e filmit. Ashtu si shoqja e tij e ngushtë dhe ylli i filmit Judy Garland – aktore e rrallë kryesore me të cilën ai nuk flinte – Rooneyt i jepeshin pilulat për ta mbajtur të kthjellët gjatë orareve të vështira të xhirimeve. Pas përfundimit të xhirimeve, ia dhanë tabletat e gjumit – për të vazhduar pastaj me raundin tjetër të stimuluesve (ndoshta amfetaminat), për të nxitur orarin tjetër të punës prej 72 orëve. Varësia nga droga zgjati deri në të shtatëdhjetat, kur pilulat e gjumit e shtynë të shtrihet në spital për shkak të

lodhjes.

Në vitin 1944, Rooney u thirr në ushtrinë amerikane ku zbaviti më shumë se dy milionë trupa gjatë 21 muajve në shërbim. Derisa ishte në ushtri, Rooney u takua me gruan e tij të dytë, Betty Jane Phillips, por martesa e tyre përfundoi shpejt pasi filloi. Më pas, në më pak se një dekadë, i pati dy martesa të tjera.

Karriera e Rooneyt u lëkund pas kthimit nga ushtria. U braktis nga MGM-i i tij i dashur dhe performoi në filma të çuditshëm ku personaliteti i tij i hareshëm ishte i papërshtatshëm për ekran. Në vitin 1961 merr vendimin më të gabuar të karrierës dhe e luan personazhin japonez Mr. Yunioshi – në Mëngjesi në Tifani [Breakfast at Tiffany's]. Performanca u kritikua si racizëm grotesk, por mbetet roli me të cilin Rooney njihet më shumë.

Bankrottoi në vitin 1962, i gjymtuar financiarisht nga dekadat e tëra të investimeve të gabuara dhe nga varësia nga bixhozi. (Dikur i habiste madje gangsterët që luanin poker, kur humbte 50 mijë dollarë në Kazinonë Riviera të Las Vegasit.) Në vitin 1996, sërisht falimentoi, pavarësisht se kishte fituar 65 mijë dollarë në javë në kulmin e viteve tetëdhjetë. Vështirë mund të dihet çmimi përfundimtar i zakonit të tij të bixhozit. Por, disa muaj para se të vdiste, ai tha: "I p... milionat!"

Vitet gjashtëdhjetë ishin dekada më e dhimbshme e jetës së yllit. Në vitin 1958 ishte martuar me Barbara Ann Thomasonin, një mis bukurie 17 vjet më e re se ai. Në martesën e tyre u rishfaq shija



Mickey Rooney dhe Barbara Ann Thomason me vajzën e porsalindur Kelly

e Rooneyt për tradhtinë bashkëshortore dhe, si reagim ndaj të tradhtisë së burrit, Barbara Ann nisi një lidhje me aktorin dhe kaskaderin e vrullshëm serb, Milos Milos. Jeta e Milosit ishte pothuajse e kundërta e Rooneyt. Vinte nga një familje e fuqishme, pasuria e së cilës ishte shpronësuar me forcë nga sovjetikët. Milosi

përfundoi duke bërë probleme në rrugët e Beogradit, derisa rrethanat e rastësishme ia dhanë detyrën e pazakontë si truproje e yllit francez të Valës së Re, Alain Delon, dhe nga aty Milosi shkoi në Holivud ku takoi Mickey Rooney dhe gruan e re të aktorit simpatik në mesomoshë. Kur u kthye në shtëpi, pas xhirimeve në Filipine, Rooney

zbuloi se Barbara Ann dhe Milosi e kishin një aferë. Çifti i martuar vendosi të shkurorëzohej, por e negociuan pajtimin – me kushtin që Barbara Ann të mos e takonte më të dashurin e saj të ri. Natën e 30 janarit 1966, Barbara Ann i tha Milosit atë për çfarë ajo dhe Rooney ishin pajtuar – pikërisht kur Rooney u shtrua në spital, për trajtimin e një



Ava Gardner dhe Mickey Rooney

sëmundjeje të gjakut të cilën e kishte marrë jashtë vendit. Të nesërmen në mëngjes, një mysafir në shtëpinë e Rooneyt në banjë gjen të vdekur Barbara Annan dhe Milosin. Ajo u vra me plumb në nofull; ai e qëlloi veten në kokë.

Policia e mbajti Milosin përgjegjës për këtë “vrasje-vetëvrasje” të dukshme, megjithëse u përhapën zërat se Rooney mund ta kishte kryer vrasjen për shkak të hakmarrjes. Megjithatë, Rooney ishte me ilaçe atë natë dhe plotësisht i pavëmendshëm për vrasjen e gruas. Kur të nesërmen i treguan, u tronditi aq shumë sa që iu zgjat qëndrimi në spital. “Vdiq kur vdiq ajo”, ka shkruar ai në autobiografinë e vet.

Pas kësaj tragjedie, karriera e Rooneyt përjetoi ringjallje graduale. Kompensimi i zhgënjimeve nga kritika dhe dështimi komercial, u bë me disa role të arritura. Ato erdhën me filmin *Palp* [Pulp] të vitit 1972, në të cilin e luajti gangsterin përkrah aktorit Michael Caine – në një ballafaqim surreal të universeve kinematografike – dhe në vitin 1979 me *Hamshorin e zi* [The Black Stallion] për të cilin u nominua për Oscar, megjithëse nuk e fitoi.

Megjithatë, një tjetër çmim Oscar ishte afër. Në vitin 1983, Bob Hope, kolegu i Rooneyt – veterani i Epokës së Artë të Holivudit – ia dorëzoi atij një Oscar nderi. Turma ku ishin Dustin Hoffman dhe Richard Pryor, u ngrit për ta duartrokatur yllin performancat më të famshme të të cilit u shfaqën para se të lindnin ata.

Rooney tashmë ishte më shumë ndjesi sesa interpretues. E solli një lidhje autentike me botën e vjetër

të estradës, pasi luajti për pesë vjet në muzikalin *Sheqerkat* [Sugar Babies] dhe bëri turne me gruan e vet të tetë dhe të fundit, Jan Chamberlin – në një shfaqje me buxhet të vogël dhe të stilit së vjetër. Rooney e nisi jetën në skenë dhe në pleqëri sërish u kthye në skenë.

Më e papritura nga të gjitha vendimet e tij të karrierës, në periudhën e vonshme, ishin pranitë e tij të shumta në pantomimën britanike. Kur *Telegraph*-i e intervistoi në vitin 2007, performonte si Baroni Hardap në një shfaqje të së Përhiturës [Cinderella] në Teatrin Perandorak të Sanderlandit – së bashku me Les Dennisin dhe Michelle Heatonin. U shfaq në dy pantomima të tjera rajonale, para se të mbaronte dekada.

Kritikat për Rooney, yllin e moshuar e bënë të rëndësishëm – në një vend të huaj dhe në një shekull të huaj. Por, e përmendën gjithashtu reagimin jashtëzakonisht të dashur të audiencës që shikonte paraqitjet e tij në skenë. Rooney gjithmonë ishte interpretues shumë i dashur – edhe në rrethanat më të jashtëzakonshme.

Dashuria e publikut ishte sidomos e rëndësishme për Rooney gjatë viteve të tij të fundit, kur ai e akuzoi thjeshtin e vet, Christopher Aber, se për një kohë të gjatë kishte abuzuar me të. Rooney pretendoi se me vite kontrollohej nga Aber i cili ia kishte mohuar qasjen në ushqim dhe në ilaçe, ia kishte konfiskuar letërnjoftimin dhe çmimet, dhe se ia kishte grabitur të ardhurat e tij të mëdha. Disa javë pasi për Aberin më në fund u lëshua urdhri



Heroi i dërrmuar, Micke Rooney

për ndalim, Rooney u shfaq para Senatit të ShBA-së për të dëshmuar emocionalisht mbi poshtërimet që kishte pësuar dhe për të bërë lutje për ndërgjegjësim më të madh për “abuzimin e të moshuarve”. Ishte momenti i tij i fundit i rëndësishëm në sytë e publikut.

Rooney vdiq më 6 prill 2014, duke lënë pas një pasuri me vlerë të vetëm 18 mijë dollarëve dhe një

familje të ndarë – debatet e së cilës mbi trashëgiminë e yllit filluan menjëherë pas vdekjes së tij.

Mbulimi mediatik i vdekjes së Rooneyt u fokusua në dekadat e dhimbshme dhe tragjeditë famëkeqe që përjetoi. *Vanity Fair* e quajti “përplasja origjinale e trenit të Holivudit”. Por, kushdo që shikon filmat e tij sot, preket nga mungesa e plotë dhe e vazhdueshme e vuajtjeve në ato

realizime. Sepse, për gati një shekull Rooney e luajti mishërimin e optimizmit të Holivudit. Ndoshta Olivier kishte të drejtë kur tha se ishte “aktori më i madh nga të gjithë”.

/Telegrafi/



Judy Garland dhe Micke Rooney (1941)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Në fundjavë zhvillohet turneu i boksit 'Lah Nimani'

PRISHTINË, 13 MAJ - Federata e Boksit e Kosovës (FboxK) ka bërë me dije se janë bërë të gjitha përgatitjet për turneun tradicional

ndërkombëtar të boksit "Lah Nimani". Ky turne do të jetë i 16-ti me radhë dhe do të mbahet më 18 dhe 19 maj në Pallatin e Rinisë dhe

Sporteve në Prishtinë. Pjesëmarrës në këtë turne do të jenë boksierë nga Kosova, Bullgaria, Polonia, Ukraina, Shqipëria, Mali i Zi dhe

Maqedonia e Veriut. Të shtunën zhvillohen gjysmëfinalet nga ora 16:00, të dielën zhvillohen finalët nga ora 16:00.



Tetëvjetori i anëtarësimit në FIFA, Ademi: Të vendosur të sigurojmë të ardhme të ndritshme

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 MAJ - Kosova para tetë vjetësh është bërë anëtarja e 210-të e FIFA-s. FFK-ja mori 141 vota për anëtarësim, nga 164 votat në Kongresin e 66 të FIFA-s që u mbajt në Meksikë. Pas thyerjes së izolimit 25-vjeçar, më 3 maj 2016, me anëtarësim në UEFA, misioni i Federatës së Futbollit të Kosovës u kompletua më 13 maj 2016, kur Kosova u pranua me shumicë votash si anëtare e FIFA-s. Një rrugëtim plot mund e sakrificë që gjithsesi hapi një faqe të re të historisë së futbollit të Kosovës.

Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, theksoi se Kongresi është trupi suprem që vendos për çështjen e Kosovës dhe kërkoi që të kalohet në votimin elektronik, ku Kosova mori 141 vota. Në fjalimin e tij para Kongresit, pas pranimit, legjenda

Fadil Vokri falënderoi presidentin e FIFA-s, zëvendëspresidentët dhe të gjithë anëtarët e Këshillit të FIFA-s. "Kjo është një datë shumë e rëndësishme për ne, pasi sot jemi pjesë e FIFA-s. Të gjithë në Kosovë i gëzohen këtij vendimi të Kongresit të FIFA-s. E kemi pritur një kohë të gjatë këtë vendim dhe jemi shumë të lumtur. Ju premtoj se ne do t'i mbrojmë vlerat e futbollit", kishte deklaruar Vokri, i cili në mënyrë simbolike mori emblemën e FIFA-s si dhuratë nga presidenti Infantino. Ndërsa presidenti aktual i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka thënë se 13 maji i vitit 2016 është një datë tjetër e rëndësishme, e paharrueshme dhe historike, jo vetëm për komunitetin e futbollit, por edhe për shtetin e Kosovës. Ademi falënderoi të gjithë ata që kontribuan në këtë rrugëtim. Duke filluar epoka e



guximshme e mëvetësimi nën udhëheqjen e Agim Bytyqit, vazhduar me epokën e rezistencës dhe ekzistencës nën drejtimin e Rexhep Abdullahut e Sabri Hashanit, dhe me epokën e ndërkombëtarizimit nën udhëheqjen e legjendës Fadil

Vokri. Ai falënderoi edhe generatat e tëra të futbollistëve, sidomos ata të periudhës së sakrificës, trajnerët, zyrtarët e federatës dhe klubeve, donatorët, si dhe të gjithë ata që kanë punuar pareshtur për të mbajtur gjallë futbollin dhe ëndrrën tonë

të përbashkët si dhe presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino. "Tani, tetë vjet pas anëtarësimit, Kosova, falë mbështetjes së UEFA-s e FIFA-s, është transformuar në një histori suksesi. Bashkërisht kemi bërë përpertime të mëdha në masivizimin dhe zhvillimin e futbollit si dhe kemi ndihmuar të rinjtë tanë të përfshihen në këtë sport. Federata e Futbollit të Kosovës është e përkushtuar për ta avancuar edhe më tej futbollin në vendin tonë. Me hartimin e strategjisë 'Themelet e së ardhmes 2024-2028' dhe punën në përmirësimin e infrastrukturës bashkë me institucionet e vendit, jemi të vendosur të sigurojmë një të ardhme të ndritshme. Jam i bindur se duke punuar së bashku do të ndërtojmë një futboll cilësor dhe një Kosovë më të fortë në arenën ndërkombëtare", ka thënë Ademi.

Januzi pasi mori çmimin 'Ylli i javës': Për titull do të luftojmë deri në fund



PRISHTINË, 13 MAJ - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 34-t në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të KF Llapi, Ahmed Januzi. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje: Skënder Kapra, Vllaznim Visoka dhe Berat Berisha. Ky komision ka vendosur që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e 34-t t'i jepet

sulmuesit veteran të llapanëve, i cili në ndeshjen kundër Malishevës, me golin e shënuar, ia siguroi tri pikë ekipit të tij që e mbajnë ende në shpresa për titull. Pasi mori këtë çmim Januzi u shpreh i lumtur që sërish u vlerësua më i miri i javës. "Ndeshja ishte kritike për kampionatin tonë, duke pasur parasysh se jemi në garë për titull. Lufta jonë kundër Malishevës ishte sfiduese, por fitorja e arritur ka qenë një hap i madh përpara. Në çdo ndeshje,

fitimi i pikëve është i rëndësishëm dhe golat e shënuar na kanë dhënë emocione të mëdha. Suksesi nuk është meritë vetëm e imja, por e gjithë ekipit. Harmonia midis lojtarëve dhe trajnerit është çelësi për sukses. Në dy javët e fundit, synojmë vetëm fitore. Do të luftojmë deri në fund, por duhet të kuptohet se arritja e titullit nuk varet vetëm nga ne, por edhe nga rezultatet e rivalit tonë", ka thënë Januzi për faqen zyrtare të FFK-së.

Guardiola: Jemi më të mirë kur luajmë nën presion

Manchester, 13 maj - Manchester City nuk gaboi ndaj Fulhamit duke triumfuar me rezultatin 0-4. "The Citizens" vijon kështu t'i ushtrorë presion Arsenalit me të cilin po garojnë për titullin kampion. Trajneri Pep

Guardiola theksoi se lojtarët e tij nuk e kanë problem presionin madje, sipas spanjollit, nën këto kushte të besuarit e tij japin më të mirën. "Lojtarët e mëdhenj argëtohen kur në lojë është presion i lartë. Këta lojtarë

janë mësuar në të gjithë këto vitet e fundit që të performojnë nën presion. Tani jemi sërish në fazën finale të kampionatit dhe kërkojmë që të mbërrijmë në ndeshjen e fundit duke e pasur vetë fatin tonë në duar. Ndaj Fulhamit

bëmë një ndeshje të madhe, tani të vazhdojmë kështu", u shpreh Guardiola. Në rast se City ia del të fitojë dy ndeshjet e radhës, atëherë "qytetarët" do ta festonin titullin e dhjetë në histori dhe të katërtin radhazi.



Gjimshiti: Mund t'i mposhtim të gjithë

BERGAMO, 13 MAJ - Atalanta mposhti 2-1 Romën në Bergamo dhe skuadra e drejtuar nga Gasperini është shumë pranë kualifikimit në Champions League për sezonin e ardhshëm. Pas përfundimit të sfidës, ka folur Berat Gjimeshi, mbrojtësi shqiptar i cili është tepër optimist për skuadrën e tij. "Fitore shumë e rëndësishme

për Atalantën", komentoi Berat Gjimeshi, i cili ka arritur numrin 48 ndeshje për zikaltrit në sezonin 2023-2024. "Edhe këtë herë u pa që e kishim përgatitur shumë mirë ndeshjen. Më e rëndësishmja ishte të mos mendonim për finalen e Kupës së Italisë, sepse ka kohë. Bëmë shumë mirë. sidomos në pjesën e parë,

mund të kishim shënuar 3-4 gola me rastet e bujshme që krijuam. Mund ta kishim mbyllur më herët ndeshjen ndaj Romës, me pak më tepër saktësi përpara. Nuk mendoj se është vendimtare. Janë edhe tri ndeshje për të luajtur në këtë kampionat. Të gjitha janë sfida vendimtare. Ne do të luajmë pesë 'finale' radhazi, duke përfshirë edhe

ato të kampionatit, do t'i marrim ndeshjet njëra pas tjetrës. Besojmë te vetja. Mund t'i fitojmë të gjitha", ka thënë Gjimeshi. "Ndeshja ndaj Liverpoolit jashtë shtëpisë na dha shumë besim për të arritur deri në fund. Ekziston një vetëdije se mund t'i mposhtim të gjithë nëse luajmë kështu. Për mendimin, kundërshtarët



hasin në vështirësi kur luajnë ndaj nesh. Kështu duhet të jetë edhe në pesë ndeshjet e fundit të këtij sezoni", ka deklaruar Gjimeshi.

Presidenti Ademi dhe përzgjedhësi Foda mbajnë takim me përzgjedhësit e përfaqësuesëve të grupmohave

PRISHTINË, 13 MAJ - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Franco Foda, bashkë me presidentin e FFK-së, Agim Ademi, kanë takuar sot trajnerët e grupmohave të ekipeve përfaqësuese, duke filluar nga ekipi U-15 deri tek ekipi U-21. Në këtë takim përzgjedhësi Foda dhe presidenti Ademi kanë folur para trajnerëve për vizionin e Federatës së Futbollit të Kosovës për zhvillimin e ekipeve përfaqësuese si dhe rolin e Federatës në këtë rrugëtim. Më pas përzgjedhësi Foda ka njoftuar trajnerët me mënyrën e tij të punës me ekipin "A", duke dhënë detaje të formës së punës që mund të implementohen edhe nga ekipet e grupmohave. "Foda ka kërkuar nga trajnerët e grupmohave që të



bëhet identifikimi sa më i hershëm i futbollistëve me potencial të lartë dhe të punohet sa më shumë me ta, në mënyrë që të jenë sa më të gatshëm për të qenë pjesë e Përfaqësueses A. Ndërsa presidenti Ademi ka premtuar

përkrahjen maksimale nga ana e Federatës që shtabet teknike të të gjitha grupmohave, të kenë mundësi për t'i implementuar idetë e tyre për zhvillimin e ekipeve përfaqësuese", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Denveri barazon serinë ndaj Minnesotas, Indiana bën ligjin në fushën e saj

DENVER, 13 MAJ - Pas zhgënjimit në dy takimet e para në fushën e saj, skuadra e Denverit ka triumfuar në dy sfidat e radhës në Minnesota, duke barazuar 2-2 serinë. Ekipi kampion i NBA-s fitoi me rezultat 115-107, në një ndeshje me rivalitet dhe emocione shumicën e kohës. Nikola Jokiq me 35 pikë ishte më i miri në fushë për Denverin, mbështetur edhe nga Aaron Gordon me 27 pikë. Në kahun tjetër, Anthony Edwards realizoi 44 pikë për Minnesotab, por që nuk mjaftuan për ta evituar humbjen. Edhe në Konferencën e



Lindjes, barazim 2-2 me ndeshje mes New York e Indianas, me këtë

të fundit që i fitoi dy sfidat në fushën e saj. Indiana triumfoi thellë 121-89 ndaj nju-jorkezëve. Haliburton me 20 pikë ishte lojtari më i mirë i Indianas, por diferencën e bëri stoli, nga ku erdhën 57 pikë. Për nju-jorkezët u dallua Burksi me 20 pikë, por që mbetën për statistikë.

KONFERENCA E LINDJES - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

New York - Indiana 89-121 (2-2)
Boston - Cleveland (2-1)

KONFERENCA E PERËNDIMIT - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Denver - Minnesota 115-107 (2-2)
Oklahoma - Dallas (1-2)

SHKURT

Tri klube italiane në garë për Zhegrovën

Edon Zhegrova pritet të largohet nga Lille gjatë afatit kalimtar veror, për të bërë një hap para në karrierën e tij. Sulmuesi kosovar është duke kaluar nëpër një formë të shkëlqyer këtë edicion pasi ka impresionuar me gola dhe asistime. Falë paraqitjeve spektakolare me fanellën e Lilles, për Zhegrovën interesim kanë shprehur skuadra të mëdha kryesisht nga Italia si Juventus dhe Napoli. Por së fundmi në garë për yllin dardan është futur edhe gjiganti tjetër italian Roma. "Il Tempo" ka shkruar se Roma e sheh Zhegrovën si futbollistin ideal për krahun e djathtë të sulmit dhe po e përcjell ecurinë e tij. "Giallorosët" kanë synim t'i marrin dy sulmues anësorë dhe, përveç Federico Chiesas, ata duan transferimin edhe të Edon Zhegrovës. 25-vjeçari këtë edicion ka zhvilluar 45 ndeshje zyrtare teksa ka shënuar 12 gola dhe ka asistuar në nëntë të tjerë. Lille është i hapur ta shesë kosovarin, por synon që nga largimi i tij të fitojë mbi 25 milionë euro.

Mësohen datat kur do të luhen Egnatia - Vllaznia dhe Partizani - Skënderbeu

Është hedhur shorti për "Final Four" në stadiumin "Air Albania" në sallën e konferencave për shtyp. Skuadrat ishin ndarë në dy vazo. Te vazo 1 ishin kryesuesit e Egnatias dhe Partizani i vendit të dytë. Ndërsa te vazo 2 ishin Vllaznia dhe Skënderbeu, që u renditën në vendet 3 dhe 4. Shorti vuri përballë Egnatia - Vllaznia dhe Partizani - Skënderbeu. Partizani - Skënderbeu do të luhet me datën 17 maj. Dy ditë më vonë Egnatia - Vllaznia më 19 maj. Më pas finalja e madhe në datën 26 maj. Për sa iu përket gjysmëfinaleve, në rast barazimi kualifikohet Egnatia (me Vllazninë) dhe Partizani (me Skënderbeun), pasi u renditën më lart në sezonin e rregullt.

Mick Schumacher, afër rikthimit në Formula 1

Vendi i lënë bosh nga Lewis Hamiltoni te Mercedesi mund të shoqërohet edhe me atë të pilotit rezervë, që aktualisht mbulohet nga Mick Schumacher. Sipas medieve gjermane, djali i Michael Schumacherit mund të garojë me Alpine sezonin tjetër. Si Esteban Ocon ashtu dhe Pierre Gasly, dy pilotët aktualë të Alpines, pritet të largohen nga makina franceze. Për këtë arsye, afrimi i Mick Schumacherit duket një formalitet, pasi piloti gjerman aktualisht garon për Alpine edhe në botërorin WEC. Kjo duket se do ta lehtësonte kalimin e Mick në Formula 1 që, në fakt, do të ishte një rikthim për të pas dy viteve me Haas. Duket se Alpine është mundësia e vetme për gjermanin, pasi makinat e tjera thuhet janë të kompletuara. Pas një viti të parë jo fort pozitiv, në sezonin e dytë në Formula 1, Mick Schumacher bëri një paraqitje më të mirë, duke grumbulluar edhe pikët e para në karrierën e tij. Gjithsesi, për të nuk po vjen ende një ofertë nga një makinë kampione.

Fury dhe Usyk, gati për përballjen e madhe

Më 18 maj në Riad të Arabisë Saudite do të zhvillohet dueli i madh i peshës së rëndë në boks mes dy kampionëve të pamposhtur: Britanikut Tyson Fury (WBC) dhe ukrainasit Oleksandr Usyk (WBA, WBO, IBF). Kjo do të jetë hera e parë që nga viti 1999 që boksi do të ketë

një kampion të vetëm, që do t'i mbajë të gjithë titujt. Një përballje madhështore, e konsideruar si sfida e shekullit, që pritet të nisë në mesnatën e së shtunës. Një duel me 12 raunde që do të zhvillohet në "Kingdom Arena", mes dy boksierësh që ende nuk kanë asnjë

humbje në karrierën e tyre. Fury ka një rekord prej 34 fitoresh e 1 barazim, ndërsa Usyk 21 fitore e asnjë humbje. E gjithë bota është duke pritur për këtë sfidë të madhe, ndaj vështirë të përcaktosh një fitues. Usyk, 37 vjeç, vjen nga fitorja me Dubois në gushtin e vitit të

kaluar, ndërsa Fury, 35 vjeç, mposhti Ngannou në tetor 2023. Atë mbrëmje do të zhvillohen edhe 7 duele të tjera, përfshi edhe atë për titullin kampion bote në peshën "cruiserweight" mes Jai Opetaia dhe Mairis Briedis, titull që është vakant.

Dy boksierët do të dalin në konferencën për shtyp më 16 maj, ndërsa më 17 maj do t'i kryejnë peshimet zyrtare. Nuk pritet ndonjë surprizë gjatë këtyre ditëve dhe e gjithë bota pret të shohë një spektakël të vërtetë në ring më 18 maj.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qera te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 14.05.2024 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qera.

Shpallje Publike T-24-5

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.
Adresa e AK: Parku Industrial
MITROVICË
40000

Personi Kontaktues: Behxhet Nimani
E-mail: behxhetnimani@hotmail.com
Telefoni: +381 28 538 050
Faks: +381 28 539 202

Shpallja Publike

Qëllimi i ofertës:

- Dhënie me qera e hapësirave të objekteve në Njësinë Biznisore FPP
- Sipërfaqja dhe çmimi fillestar

1. Njësia Biznisore Fabrika e paisjes së Procesit

Njësia Biznisore Fabrika e Paisjes së Procesit -FPP												
Nr	Emri i Objektivit	Sipërfaqja e mbuluar (m2)	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i Qerasë (€)	Sipërfaqja e pambuluar (m2)	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)	Gjithsejt qeraja (€)
1	Depoja e Bombolave	227.78	2.50	0.45	2.95	671.95	100.00	0.50	0.09	0.59	59.00	730.95
2	Depoja Nr. 1	500.00	1.10	0.20	1.30	649.00	207.00	0.50	0.09	0.59	122.13	771.13
3	Sipërfaqe e jashtme				0.00	0.00	200.00	0.50	0.09	0.59	118.00	118.00
4	Restaurani i vjetër	500.00	0.90	0.16	1.06	531.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	531.00
5	Ndërtesa e Administratës	687.00	0.90	0.16	1.06	729.59	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	729.59

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë
Data e shpalljes: 14.05.2024
Sqarimi: deri me 30.05.2024
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 30.05.2024
Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Origjinali dhe Kopja)
Afati i fundit i dorëzimit: 30.05.2024 në 11:00
Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A. Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

Kërkesat minimale të kualifikimit:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
- Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH (vetëm për ofertuesit vendor)
- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
- Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

Shënime shtesë:

Çmimi i ofertës: Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.
Obligimet: Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe te gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.
Oferta: Duhet të përfshijë çmimin për m² duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks1.
Pagesa: Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.
Operatorët ekonomik: që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

Aneksi 1 OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T)	

Llogaritja e vlerës së qerasë		
a	Sipërfaqja e mbuluar m ²	
b	Çmimi për metër katrorë (€)	
c = b*18%	Çmimi për metër katrorë me TVSH (€)	
D=a*c	Vlera e qerasë për sipërfaqen e mbuluar (€)	
e	Sipërfaqja e pa mbuluar m ²	
f	Çmimi për metër katrorë (€)	
g = f*18%	Çmimi për metër katrorë me TVSH (€)	
H=e*g	Vlera e qerasë për sipërfaqen e pa mbuluar (€)	
I=D+H	Gjithsejt qeraja (€)	

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneks 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund të bëhet deri me datën 14.05.2024 për mes e-mail ose në Zyrën e Shitjes.

Aneks 4. Përshkrimi i Aseteve

Përshkrimi i aseteve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale "ashtu siç janë dhe ku janë" dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e aseteve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e aseteve.

Objekti është i ndarë në lote,

Trepça Sh.A. përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

DHËNIE ME QIRA E HAPËSIRËS

Oferta duhet të jepet për m² dhe llogaritja përfundimtare në faturim



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Runfill" Sh.p.k Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Fabrikën e Prodhimit të Produkteve për Pastrim-Detajim, Shamponëve dhe Aromave për Makina, në ZK. Dushanovë, Komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.06.2024 në ora 10:00 në Shkollën e Mesme të Lartë - Gjinnazi "Gjon Buzuku" Prizren., do të organizohet debat publik nga Kompania "Runfill" Sh.p.k Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Fabrikën e Prodhimit të Produkteve për Pastrim-Detajim, Shamponëve dhe Aromave për Makina, në ZK. Dushanovë, Komuna e Prizrenit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsviMPR68pjZDwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Runfill" Sh.p.k Prizren, Fabrikën e Prodhimit të Produkteve për Pastrim-Detajim, Shamponëve dhe Aromave për Makina, në ZK. Dushanovë, Komuna e Prizrenit

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Durrije Ferdulli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 1,2,3 të lëshuar nga SH.M.E "Kadri Kusari", Gjakovë.
- Pejkerë Muhaxhiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.E "Kadri Kusari", Gjakovë.
- Granit Lluka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; I,II,III,IV të Gjinnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.
- Olta Xhemshiti shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10, 11 të Gjinnazit "Ahmet Gashi" Prishtinë.
- Kajtaz Fetahu shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.
- Fatmir Bajrami shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Dervish Tejeci shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Vëllezërit Frashëri" Planeje.
- Dashurije Ninaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Vëllezërit Frashëri" Planeje.
- Dion Thaqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Zef Lush Marku" Velezhe.
- Blendin Thaqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Zef Lush Marku" Velezhe.
- Asmija Skenderi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Lekë Dukagjini" Prizren.
- Leonit Raduni shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu "Ibrahim Fehmiu" Prizren.
- Trim Ademi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 811929481, "Parku Lounge" SH.P.K. Ferizaj.
- N.T.P. "Euro Tranzit" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810446329.
- Egzon Ukmata nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës fillore "Emin Duraku", Gjakovë.
- Mehmet Salih nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.
- Shkëndije Ukshini nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës fillore "Ganimete Terbeshi", Poneshec.
- Blerim Nuraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

